



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ENUAR V MERKO
ZYRA PËRMBARIMORE E.G BAILIFF SERVICE

Adresa: Rr. "Themisokli Gërmenji", Pallati "Ambasador 1", Kati 2, Tiranë; Cel: +355 68 21 93 435; e-mail :enuar.merko@gmail.com



Nr. 11454 . Prot

Tiranë më 03.08.2022

URDHËR
PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

Në Tiranë sot më datë 03.08.2022

Unë **Enuar V MERKO** Përmbarrues Gjyqësor me Liçensë Nr.123 pasi studiova dosjen përmbarrimore si dhe në zbatim të Urdhërit Ekzekutimit, vendimi Nr.930 Akti datë 16.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KONSTATOVA

Shoqëria "Micro Credit Risk" Sh.P.K., në cilësinë e kreditorit, ka paraqitur pranë Zyrës Përmbarrimore "E.G BAILIFF SERVICE" me Përmbarrues Gjyqësor Enuar V MERKO, kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Kontratë Kredie datë 28.09.2020, me palë dhe objekt:

- Kreditor : Shoqëria "Micro Credit Risk" Sh.P.K.
- Debitor : Shoqëria "Veral-Alumin" Sh.P.K.
- Dorëzanës : Mirjana Skënderaj
- Me objekt : Kthim Kredie

Pasi janë zbatuar procedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titullit Ekzekutiv, Kontratë Kredie datë 28.09.2020.

Me vendim të Përmbarruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv, Kontratë Kredie datë 28.09.2020 ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Me "Urdhër" me Nr. 10830 Prot. dt. 19.07.2022 kemi urdhëruar bllokimin e llogarisë së debitorit Shoqëria "Veral-Alumin" Sh.P.K. me NIPT L81613010T dhe Mirjana Behar Skënderaj e datëlindjes 03.08.1980 me nr.personal I05803013T në favor të kreditorit Shoqëria "Micro Credit Risk" Sh.P.K.



Nga ana e debitorit Shoqëria "Veral-Alumin" Sh.P.K. me NIPT L81613010T përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm Znj. Mirjana Behar Skënderaj jemi informuar se është kryer bllokimi i shumës së detyrimit pranë Banka Credins Sh.A në vlerën 868'000 (Tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, fiksuar në "Proçes Verbal" datë 26.07.2022.

Në këto kushte, me urdhër për vendosjen e sekuestros ekzekutive Nr. 930/1 Regj., datë 26.07.2022 mbi llogarinë e debitorit Shoqëria "Veral-Alumin" Sh.P.K. me NIPT L81613010T me qëllim përmbushjen e detyrimit është urdhëruar kalimi i shumës pranë llogarisë bankare të përmbauesit gjyqësor.

Rezulton se ekzekutimi i Urdhërit të Ekzekutimit vendimi Nr.930 Akti datë 16.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, *bazuar në nenin 616/a të Kodit të Proçedurës Civile*, është pushuar me vendim të përmbauesit gjyqësor.

Në këto kushte për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Kontratë Kredie datë 28.09.2020 duhet të kryhet heqja e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore Shoqëria "Veral-Alumin" Sh.P.K. me NIPT L81613010T dhe Mirjana Behar Skënderaj e datëlindjes 03.08.1980 me nr.personal I05803013T.

Për këto arsye, bazuar në nenin 617 të Kodit të Proçedurës Civile si dhe dhe Ligjin Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbauesor Gjyqësor Privat"

URDHËROJMË

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore:
 - a. Shoqëria "Veral-Alumin" Sh.P.K. me NIPT L81613010T
 - b. Mirjana Behar Skënderaj e datëlindjes 03.08.1980 me nr.personal I05803013T për 100% të kuotave të zotëruara në Shoqërinë "Veral-Alumin" Sh.P.K. me NIPT L81613010T
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Proçedurës Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

ENUAR V MERKO

